



Monitorimi i të drejtave të fëmijëve në nevojë nën përkujdesje sociale rezidenciale



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Monitorimi i të drejtave të fëmijëve në nevojë nën përkujdesje sociale rezidenciale

Publikimi i këtij raporti, u mbështet nga Save the Children në kuadër të projektit “Nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve për një qeveri më të përgjegjshme në nivel lokal dhe kombëtar në Shqipëri”.

Këndvështrimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport janë vetëm të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

Tiranë, 2024

Përmbajtja:

1. Hapje nga komisioneri i Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve	4
2. Hyrje: Roli i AP-së, Seksionit të MPDF-së.....	5
3. Qëllimi dhe objektivat e monitorimit	6
4. Metodologjia	7
5. Gjetje të monitorimit	20
6. Rekomandime.....	24

DY FJALË PËR KËTË RAPORT

Shënim:

Ky raport paraqet një vështrim të përgjithshëm të situatës së mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore (referuar në këtë raport si institucione përkujdesjeje apo IPSH). Ai përmban informacion të përmbledhur mbi situatën e infrastrukturës, stafit, zbatimit të standardeve të cilësisë së shërbimit, si dhe përfundime e rekomandime të përgjithshme për të gjitha shërbimet e sistemit rezidencial publik për fëmijët pa kujdes prindëror të moshës 0-18 vjeç.

Informacione më të detajuara dhe specifike për secilin shërbim, si dhe rekomandimet përkatëse për institucionet shtetërore vendore dhe qendrore nga të cilat varen ato, u janë dërguar secilit prej këtyre institucioneve në përfundim të procesit të monitorimit nga Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, pranë Avokatit të Popullit, dhe po ashtu gjenden të publikuara në faqen online të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjatë veprimtarisë së tij, Avokati i Popullit (AP) ka pasur dhe ka në fokus të veçantë fëmijët në situata të cenueshme, ku përfshihen edhe fëmijët që janë nën përkujdesjen alternative të shtetit.

Të gjithë fëmijët, pa përjashtim, duhet të jetojnë në një mjedis ku u ofrohet mbështetje, mbrojtje dhe përkujdesje, si dhe ndihmë për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë. Kur familja e një fëmije nuk është në gjendje, edhe me mbështetje, që të sigurojë kujdesin e duhur për fëmijën, shteti është përgjegjës për t'i siguruar fëmijës kujdesin e duhur.

Fëmijët që janë të vendosur në përkujdesje alternative në institucione rezidenciale duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat që kanë sipas konventave ndërkombëtare dhe ligjeve në fuqi. Vendosja në përkujdesje alternative në institucion duhet të jetë zgjidhja e fundit dhe vetëm nëse fëmija është i rrezikuar, ose nëse qëndrimi në familjen e tij është i pamundur. Institucionet rezidenciale duhet të kenë standarde cilësore për t'u ofruar këtyre fëmijëve zhvillim dhe jetesë të denjë, në interesin më të lartë të tyre.

AP-ja ka theksuar gjithashtu rëndësinë që ka procesi i deinstitutionalizimit dhe zëvendësimi i përkujdesjes institucionale me shërbime me bazë komunitare, nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse. Deinstitutionalizimi është një proces i gjatë, ndaj nevojitet planifikim dhe vlerësim periodik nga ana e autoriteteve përkatëse shtetërore, për të garantuar riintegrimin në shoqëri të fëmijëve të institucionalizuar, e sidomos të atyre që kanë qenë të institucionalizuar për një kohë të gjatë.

ROLI I AP-SË DHE SEKSIONIT PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Institucioni i Avokatit të Popullit është parashikuar për herë të parë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të miratuar në nëntor 1998, kurse ligji “Për Avokatin e Popullit” është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në shkurt të vitit 1999.

Drejtimi i Institucionit të Avokatit të Popullit është monokratik. Avokati i Popullit zgjidhet nga tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai ka si mision të tij parandalimin e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe individit. Avokati i Popullit vepron në bazë të ankesës apo kërkesës së paraqitur pranë tij. Ai vepron edhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike.

Institucioni i Avokatit të Popullit është i organizuar në 5 seksione dhe çdo seksion ka 1 (një) Komisioner dhe 2 (dy) ndihmëskomisionerë.

- Seksioni për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të tyre;
- Seksioni për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor;
- Seksioni i Përgjithshëm;
- Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve
- Mekanizimi për Parandalimin e Torturës, Trajtitimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës;

SEKSIONI PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve është një nga seksionet e specializuara të Avokatit të Popullit që mbron, monitoron dhe promovon të drejtat e fëmijëve dhe të të rinjve nën moshën 18 vjeç në Republikën e Shqipërisë. Këto të drejta janë të parashikuara në Kushtetutë, në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe në ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Seksioni

i Fëmijëve përbëhet nga Komisioneri dhe tre (3) ndihmëskomisionerë. Komisioneri drejton dhe përfaqëson seksionin në çdo hap të veprimtarisë ligjore dhe administrative.

Mbrojtja, monitorimi dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve nga Seksioni

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve mbron të drejtat e fëmijëve duke trajtuar ankesat për shkeljen e këtyre të drejtave. Seksioni kryen hetim administrativ për veprimet apo mosveprimet e institucioneve publike, të cilat kanë pasur efekt negativ mbi fëmijën. “Institucionet publike” përfshijnë ministritë, agjencitë shtetërore, shërbimet shëndetësore, shkollat, shërbimet sociale, autoritetet vendore, etj.

Gjatë kryerjes së hetimit administrativ, Seksioni është i pavarur dhe i paanshëm në punën e tij, duke pasur në konsideratë vetëm interesin më të lartë të fëmijës.

Pas kryerjes së hetimit administrativ, Seksioni mund të paraqesë edhe rekomandime për marrjen e masave dhe vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organet publike që, sipas tij, kanë kryer shkeljen. Organet publike të cilave iu është drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë atë dhe t'i kthejnë përgjigje Seksionit, brenda afateve ligjore, në lidhje me masat dhe veprimet e ndërmarra për të adresuar shkeljen e kryer.

QËLLIMI DHE INSTITUCIONET SHËRBIMOFRUESE, OBJEKT I INSPEKTIMIT

Në kuadër të mandatit që institucioni i Avokatit të Popullit (AP) ka për mbrojtjen, promovimin dhe garantimin e të drejtave të fëmijës, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve ka zhvilluar një proces inspektimi të përgjithshëm të situatës së të drejtave të fëmijëve përfitues të shërbimit të mbrojtjes shoqërore në institucionet publike të përkujdesjes.

Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë vlerësimi i situatës së të drejtave të fëmijëve që marrin shërbimin, garantimi i të drejtave të tyre për mbijetesë dhe zhvillim harmonik në përputhje me fazën e tyre të zhvillimit, si dhe garantimi i interesit më të lartë të fëmijës në këto institucione të përkujdesjes alternative.

Inspektimi ka nxjerrë një sërë gjetjesh, të cilat janë shoqëruar edhe me rekomandimet përkatëse drejtuar jo vetëm institucioneve të përkujdesjes, por edhe institucioneve mbikëqyrëse të tyre, si bashkitë përkatëse, Shërbimi Social Shtetëror dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me qëllim marrjen e masave për t'i adresuar problematikat e identifikuara në kuadër të detyrimeve dhe kompetencave ligjore të secilit institucion për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Institucionet e përkujdesjes, objekt i këtij inspektimi, janë:

1. Shtëpia e Foshnjës 0-5 vjeç, “Lulet e Vogla”, Korçë

2. Shtëpia e Foshnjës 0-5 vjeç, Vlorë
3. Shtëpia e Foshnjës 0-5 vjeç “Hannah dhe Rozafa”, Tiranë
4. Shtëpia e Foshnjës 0-6 vjeç, Durrës
5. Shtëpia e Foshnjës 0-6 vjeç, Shkodër
6. Shtëpia e Fëmijës, “Zyber Hallulli”, Tiranë
7. Shtëpia e Fëmijës, 6-15 vjeç, Shkodër
8. Shtëpia e Fëmijës 6-15 vjeç, “Vangjel Pulla”, Sarandë
9. Shtëpia e Fëmijës 16-18 vjeç, Shkodër

METODOLOGJIA

Në zbatim të Urdhrit nr. 24, datë 7.02.2023, të Avokatit të Popullit, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve realizoi një inspektim të përgjithshëm në 9 institucione të përkujdesjes shoqërore për fëmijët 0-18 vjeç, të vendosura në 6 bashki të vendit: Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Sarandë. Institucionet e përkujdesjes për fëmijë janë të konceptuara dhe organizuara për të ofruar shërbim rezidencial sipas grupmoshave dhe fazave të zhvillimit të fëmijëve, përkatësisht: 0-5 vjeç; 6-15 vjeç dhe 16-18 vjeç.

Bazuar në objektivat specifike të inspektimit, të cilat lidhen me:

- Kontrollin e performancës në institucionet që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore për fëmijët në nevojë, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit dhe procedurave që ndjekin këto institucione;
- Vlerësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar nga personeli i institucioneve të përkujdesjes shoqërore;
- Vlerësimin e mjediseve dhe kushteve fizike të institucionit;
- Vlerësimin e situatës sociale, psikologjike dhe shëndetësore të përfituesve të shërbimit në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- Respektimin e të drejtave të fëmijëve, në zbatim të legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar në fuqi;
- Verifikimin e mjaftueshmërisë së buxhetit të vënë në dispozicion për garantimin e mirëqenies dhe të të drejtave të fëmijëve.

u hartua dhe metodologjia e inspektimit, e cila u bazua në: marrjen e informacionit nga dokumente shkresore, vështrimin e përgjithshëm mbi legjislacionin, dokumente politike, plane veprimi, si dhe informacione nga raporte monitorimi e vlerësimi të hartuara deri tani; administrimin e një pyetësori dhe realizimin e intervistave me drejtues dhe punonjës

të institucioneve, si dhe kontakte e konsultime me fëmijët përfitues. Informacioni i mbledhur është hedhur në formatin standard për inspektimet e institucioneve të kësaj tipologjie.

Grupi inspektues i AP-së, i përbërë nga juristë dhe punonjës socialë, është fokusuar në:

- zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e institucioneve;
- shqyrtimin e dokumentacionit në dosjet personale të përfituesve e të punonjësve dhe dokumentacionit në lidhje me shërbimin;
- zhvillimin e intervistave me punonjësit dhe bashkëbisedime me fëmijët përfitues të institucionit, për cilësinë e ofrimit të shërbimit;
- nivelin e zbatimit të paketës së akteve nënligjore dhe të legjislacionit në fuqi, në kontekstin e respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe garantimit të interesit më të lartë të tyre;
- monitorimin e mjediseve dhe kushteve të IPSH-ve ku ofrohen shërbimet për fëmijët në nevojë.

Në përfundim të inspektimit, grupi i punës i AP-së ka zhvilluar bisedën përmbyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtpërdrejtë me përfituesit, ku u bënë të njohura problematikat e evidentuara gjatë inspektimit dhe u lanë rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuara në fund të secilit raport. Raportet për secilin shërbim, së bashku me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, u janë bërë me dije edhe institucioneve të bashkisë, Shërbimit Social Shtetëror, si dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Konsiderata etike

Duke pasur parasysh tipologjinë e shërbimeve dhe përfituesve, grupi monitorues ka mbajtur parasysh disa çështje etike, në mënyrë që procesi i monitorimit të kryhej si duhej, me integritet, duke vlerësuar ndjeshmërinë e problematikave që mbartin përfituesit fëmijë dhe duke pasur gjithmonë parasysh interesin e tyre më të lartë.

Qasja me në qendër fëmijën: gjatë procesit të monitorimit, pjesë e tij ishin edhe elementet e pjesëmarrjes së fëmijëve, duke i dhënë vlerë pikëpamjes së tyre në lidhje me situatën e të drejtave dhe cilësinë e shërbimit që marrin.

Interesi më i lartë i fëmijës: ky element është konsideratë parësore e çdo profesionisti që punon me fëmijët dhe për fëmijët, në mënyrë që të mos cenohet mirëqenia e tyre psikoemocionale apo mundësia e shkaktimit të demit, nëse ata përfshiheshin në një proces monitorimi. Grupi monitorues ka pasur gjithmonë parasysh që qëndrimet, mënyra e ndërveprimit me fëmijët, apo pyetjet drejtuar atyre të mos shkaktonin stres apo shqetësim tek ata.

Konfidencialiteti: grupi monitorues është siguruar që të komunikojë në mënyrë të hapur dhe transparente, në grup me fëmijët përfitues, dhe asnjë e dhënë e përdorur në raport nuk cenon privatësinë apo zbulon identitetin e fëmijëve me të cilët është kontaktuar.

Ndjeshmëria e situatës së fëmijëve përfitues: gjatë vizitës monitoruese, si dhe në ndërveprimet e grupit monitorues me fëmijët, janë mbajtur parasysh elemente të problematikave psikoemocionale, traumës së ndarjes, mungesës së ngrohtësisë prindërore, individualitetit, etj., që mbartin fëmijët jashtë kujdesit prindëror dhe nën kujdesin e një institucioni të përkujdesjes shoqërore.

Ndarja e gjetjeve të monitorimit me strukturat dhe shërbimet e monitoruara: Përpara finalizimit të këtij raporti, grupi monitorues i AP-së ka zhvilluar bisedën përmbyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtpërdrejtë me përfituesit, si dhe është ndarë një material shkresor me institucione të tjera të nivelit më të lartë, në të cilin janë ndarë gjetjet dhe rekomandimet për secilin nga shërbimet që janë objekt i këtij monitorimi.

Profili i shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për fëmijë:

Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar se të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror e kanë individë ose familje që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje t’i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe të gjithë individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale.

Detyrimin ligjor për fuqizimin e familjeve në kushtet e vështira socio-ekonomike e ka pushteti vendor. Po kështu, sipas ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar jetë familjare e sociale të përshtatshme.

Referuar pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale për fëmijë janë në varësi administrative të bashkisë përkatëse.

Ky shërbim funksionon sipas standardeve dhe procedurave të bazuara në politikat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përputhje me legjislacionin për sistemin e mbrojtjes shoqërore. Fëmijët e sistemuar në këto institucione janë aty për arsye të varfërisë, mungesës së mbështetjes së duhur nga familjet e tyre, si rezultat i problemeve sociale, problemeve të thella të shëndetit mendor të prindërve apo familjarëve, moskthimit të fëmijëve në familjet biologjike si pasojë e mungesës së shërbimeve alternative me baze familjare e komunitare, dhe për fuqizimin e familjes biologjike.

Vendosja e kategorive në nevojë në qendrat e kujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e individit ose përfaqësuesit të tij ligjor, pas vlerësimit të gjendjes sociale, ekonomike dhe mjekësore të individit. Në rastin konkret, duke qenë shërbim i tipit rezidencial për fëmijë, ata janë vendosur në përkujdesje shoqërore pas një kërkesë të prindit apo kujdestarit të tyre ligjor, ose janë vendosur me vendim gjykate, nëpërmjet një “Urdhri Mbrojtjeje”, pas vlerësimit të ambientit familjar si jo të përshtatshëm për mirëqenien fizike, psikoemocionale, sociale dhe edukative të fëmijës.

Shërbimet e përkujdesjes shoqërore për fëmijë bazohen në disa parime bazë si:

- e drejta për të përfituar shërbime të mbrojtjes shoqërore
- respektimi dhe garantimi i vlerave dhe personalitetit individual
- gjithëpërfshirja, mosdiskriminimi dhe mundësitë e barabarta
- transparenca dhe paanshmëria
- pavarësia në kryerjen e veprimeve ditore të vetë fëmijëve (ushqyerja, administrimi i veshjeve dhe proceseve, rutinës normale të kujdesit personal)
- integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në komunitet
- partneriteti

Shërbimet që ofrohen nga institucionet e përkujdesjes shoqërore janë ato të **mirërritjes së fëmijëve**, duke garantuar strehim, ushqim, siguri jetese, veshmbathje, **përkujdesje shëndetësore**, arsimim, si dhe **shërbime psikosociale**, aktivitete argëtuese, informuese, etj.

Shërbimet publike të përkujdesjes shoqërore për fëmijë janë të organizuara në nivel rajonal dhe të ndara sipas grupmoshave që reflektojnë fazën e zhvillimit biologjik të fëmijës. Ato ndahen në institucione të përkujdesjes për fëmijë të moshës 0-5 vjeç (të njohura si shtëpia e foshnjës dhe parashkollori); fëmijë të grupmoshës 6-15 vjeç (apo shtëpia e fëmijës në moshë shkolle) dhe për të rinj të grupmoshës 16-18 vjeç.

Duke ofruar një shërbim rajonal dhe me raste edhe kombëtar (Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli” apo Shtëpia e të Rinjve), karakteristikë e këtij shërbimi është se ato presin dhe ofrojnë shërbim për fëmijë të ardhur edhe nga zona të tjera të vendit, të ndryshme nga ajo e vendndodhjes së institucionit të përkujdesjes brenda apo edhe nga rajone të tjera jashtë rajonit në fjalë. Kjo situatë në vetvete krijon sfida në aspektin e mbajtjes dhe ushqyerjes së marrëdhënies fëmijë-familje dhe cilësisë së këtyre marrëdhënieve.

Shpesh, largësia, shpenzimet e transportit dhe akomodimit, shkëputja për periudha më të gjata nga puna apo angazhime të tjera, pengojnë prindërit biologjikë apo familjarë të tjerë që të mbajnë marrëdhënie konstante dhe domethënëse me fëmijët e tyre në shërbimin rezidencial. Po ashtu, një ndarje e tillë territoriale krijon vështirësi në menaxhimin e

flukseve, si dhe shërbimeve në nivel bashkie (duke pasur parasysh rolin dhe përgjegjësitë e pushtetit vendor në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes shoqërore) edhe për ata fëmijë që nuk vijnë nga zona territoriale e bashkisë apo rajonit përkatës. Vështirësitë krijohen edhe në koordinimin e përpjekjeve për menaxhim të integruar të rasteve të fëmijëve në sistemin rezidencial mes punës që bëhet me fëmijën në institucion dhe familjen biologjike apo të zgjeruar për ta fuqizuar e mbështetur në mënyrë që të tejkalojë vështirësitë dhe të jetë në gjendje ta rimarrë fëmijën në gjirin e vet.

Në aspektin infrastrukturor, një pjesë e mirë e shërbimeve janë të vjetra, të trashëguara nga sistemi i shkuar, dhe pavarësisht se janë bërë ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës, ato rezultojnë të pamjaftueshme e në ndonjë rast nuk sigurojnë mirëqenien e fëmijëve dhe nuk realizojnë dot një kontekst të një natyre familjare si në konceptin e shtëpisë-familje.

Mbështetja financiare e veprimtarisë së institucioneve të përkujdesjes shoqërore për fëmijë realizohet nga fondet e buxhetit të shtetit nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe nga fonde të bashkisë përkatëse në zëra si: paga, shpërblime, sigurime shoqërore, shpenzime operative, mirëmbajtje/rehabilitim, apo dhe nga donatorët, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menuja ushqimore: Shërbimi Social Shtetëror, nëpërmjet komunikimit zyrtar, dërgon normat ushqimore për institucionet e përkujdesjes shoqërore, që ofrojnë shërbime për fëmijët bazuar në urdhra dhe udhëzime të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Me urdhër të Ministrit, grupi i ngritur i punës, i përberë nga specialistë të fushave përkatëse, ka hartuar dhe me pas është miratuar norma ushqimore për fëmijët 0-18 vjeç që trajtohen në “institucionet e përkujdesjes shoqërore”. Në këtë frymë, u përcaktua masa e kuotës ushqimore për fëmijët sipas grupmoshës

0-3 vjeç në masën 360 lekë

4-5 vjeç në masën 400 lekë

6-11 vjeç në masën 490 lekë

11-15 vjeç në masën 600 lekë

15-18 vjeç në masën 600 lekë

Shërbimi Social Shtetëror ka ndarë urdhrin për ushqyerje të shëndetshme me qëllim garantimin e zhvillimit normal të fëmijëve, si një udhërrëfyes të qartë për të gjithë personelin e institucioneve të përkujdesjes shoqërore, që ofrojnë shërbime për fëmijët, me informacione të detajuara mbi ushqyerjen e shëndetshme, të shoqëruara me menutë përkatëse, llojshmërinë e ushqimeve në përputhje moshën, stinët, etj.

Gjatë hartimit të menusë ditore, stafi duhet të mbajë parasysh nevojat për ushqim në përputhje me grupmoshën dhe nevojat e veçanta të fëmijëve. Lidhur më këtë, stafi duhet të ketë njohuri për nevojat ushqimore, teknikat e ushqyerjes së fëmijëve dhe çrregullimet e të ngrënit të fëmijët e vegjël dhe adoleshentët. Megjithatë, nga inspektimi

rezulton se punonjësit e kuzhinës kanë përvojë të pasur, përdorin gjerësisht gatime tradicionale të tryezave familjare bazuar në perimet dhe frutat e stinës dhe përmbushin si duhet detyrimet që përcaktohen në udhëzimet përkatëse. Menuja ushqimore është e larmishme, me vakte ushqimore që sigurojnë ushqyerje të shëndetshme. Gatimi është i përditshëm. Ofrohen 3 vakte kryesore, si dhe dy “zëmra” gjatë paradites dhe pasdites. Kampionët ushqimorë rezultuan të ruajtur në mjedise të përshtatshme dhe sipas vakteve në pjesën më të madhe të institucioneve. Kuzhinat në të gjitha institucionet e përkujdesjes shoqërore rezultojnë me investime në pajisje elektroshtëpiake dhe në serviset e ushqimit, duke krijuar mjedisin e nevojshëm për higjienë dhe cilësi.

Shërbimi shëndetësor: nga inspektimi rezulton se çdo fëmijë ka kartelën shëndetësore, është i pajisur me kartelë vaksinimi dhe kartë shëndeti. Vaksinimi i fëmijëve në institucionet e përkujdesjes kryhet rregullisht sipas kalendarit të vaksinave dhe grupmoshave të përcaktuara në të. Shërbimi shëndetësor ofrohet nga mjeku, i cili përgjithësisht ofron një shërbim me kohë të pjesshme në institucionet e përkujdesjes, aty ku nuk është pjesë e organikës me kohë të plotë. Në një rast (në ISHP Sarandë), institucioni nuk ka mjekë apo infermierë, as me kohë të pjesshme, por e merr këtë shërbim nga shërbimi shëndetësor parësor vendor. Sa u takon vizitave shëndetësore, ato bëhen në mënyrë periodike dhe në raste emergjence kur shfaqet nevoja. Çdo fëmijë deri në moshën 1-vjeçare kontrollohet çdo muaj, fëmijët e moshës 12-24 muajsh vizitohen 1 herë në tre muaj dhe për ata të moshës 2-6 vjeç bëhet një vizitë çdo 6 muaj. Të gjitha kontrollet periodike mjekësore dhe ecuria e zhvillimit psikomotor të fëmijëve rezultojnë të dokumentuar.

Për të miturit e moshës 16-18 vjeç, ky shërbim ofrohet në qendrën shëndetësore pranë institucionit rezidencial ku ata qëndrojnë, menjëherë pas regjistrimit/transferimit të kartelës shëndetësore dhe kodit të përkujdesjes shëndetësore.

Monitorimi dhe inspektimi i standardeve të shërbimit në institucione kryhet nga Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), Drejtoria e Shërbimit Social pranë bashkive, Komiteti Shqiptar i Birësimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Stafi i institucioneve ofruese të shërbimit

Detyrat dhe përgjegjësitë e stafit, sipas pozicioneve të punës, janë të parashikuara në rregulloren e brendshme të institucionit të përkujdesjes shoqërore për fëmijë. Rregullorja e institucionit përmban qëllimin, misionin dhe filozofinë e shërbimeve, objektivat dhe strategjinë, si dhe strukturën organizative, menaxhimin dhe administrimin, duke i dedikuar një pjesë të mirë përshkrimit të funksioneve, kompetencave dhe përgjegjësi të personelit, si dhe të drejtave e detyrimeve të personelit dhe të përfituesve. Po ashtu, ajo përmban detaje për shërbimet e ofruara dhe procedurat e zbatimit të standardeve dhe të shërbimeve, sipas legjislacionit për sistemin e mbrojtjes shoqërore.

Puna e stafit të institucioneve të përkujdesjes për fëmijë është e organizuar në 3 turne, sipas grafikut të turneve 8-orarshe me këto intervale kohore:

Turni 1, ora 06.30-14.30

Turni 2, ora 14.30-22.30

Turni 3, ora 22.30-06.30

Tabelë përmbledhëse e punonjësve të stafit për secilin institucion të përkujdesjes shoqërore rezidenciale për fëmijë:

Stafi	0-5 vj. Vlorë	0-5 vj. Durrës	0-5 vj. Korçë	0-5 vj. Tiranë	0-5vj. Shkodër	6-15 vj. Tiranë	6-15 vj. Sarandë	6-15 vj. Shkodër	15-18 vj. Shkodër
Drejtori i institucionit	1	1	1	1	1	1	1	1	1 ¹
Përgjegjës Sek. Social/ Punonjës social	12 + 6	1 + 1	1	1	1	1+2	1	1	9
Psikolog		1		1 kp ²		2	1	1	1
Edukator				1		4	6	5	
Kujdestar		19	9	1 ³ + 23	8	1 ⁴ + 14	6	9	2 kp
Mjek/ infirmier		1	1 kp	1kp ⁵	1	1		1	
Përgjegjës i Sektorit të Financës	6 + 4	1	1	1 + 3 ⁶	1	1	1	1	1
Kuzhinier		2	1	1		2	2	2	1
Roje						1	1		
Mirëmbajtës		1		1	1	1	1	1	1 kp
Magaznier				1	1	1			
Shofer				1					
Sanitar		1	1		1	5	3	3	1

Pavarësisht se tabela tregon një numër jo të vogël punonjësish të punësuar si edukatorë dhe kujdestarë, kjo duhet parë edhe në raport me numrin e fëmijëve që marrin shërbim në institucion, por edhe me grupmoshat e tyre. Nga ana tjetër, vihet re që në të shumtën e rasteve punonjësit kanë shumë vite punë në të njëjtin pozicion brenda institucionit dhe duke vlerësuar natyrën e shërbimit që ofrojnë, përgjegjësinë dhe ngarkesën psikologjike dhe emocionale me të cilat përballen, punonjësit që janë në kontakt të vazhdueshëm me

1. Drejtori i komanduar prej 3 vitesh, Drejtuesi i Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Shkodër
2. me kohë të pjeshme
3. Kryekujdestarë
4. Kryekujdestarë
5. Mbështetur financiarisht nga Shërbimet Sociale Bethany
6. Specialistë

fëmijët (edukatorë, kujdestarë, punonjës psikosocialë) janë të prekur edhe nga fenomeni i konsumimit profesional për të cilin nuk ka një plan ndërhyrjeje që të parashikojë në mënyrë periodike ofrimin e mbikëqyrjes profesionale të strukturuar, mbështetjes emocionale apo veprimtari të tjera që synojnë përmirësimin e shëndetit mendor dhe mirëqenies psikoemocionale të punonjësve.

Problematikë e evidentuar është fuqizimi i shërbimit psikosocial në institucionet e përkujdesjes për fëmijë. Pavarësisht se është shënuar progres në ngritjen dhe plotësimin me punonjës socialë dhe në disa raste edhe me psikologë (diku me kohë të plotë e diku me kohë të pjesshme), mbetet ende shumë për të bërë për aftësimin profesional dhe fuqizimin e këtyre profesionistëve për të ndërtuar dhe ndjekur ndërhyrje të mirëfillta (dhe cilësore) të mbështetjes psikoemocionale të fëmijëve, qoftë në mënyrë individuale apo në grup, duke synuar inkurajimin, rehabilitimin, zhvillimin e aftësive njohëse, funksionale, komunikuese apo shoqërore të fëmijëve përfitues. Kjo mbështetje psikosociale mund të jepet edhe si pjesë e shërbimeve të specializuara, gjithmonë kur ajo vlerësohet e nevojshme nga strukturat e vlerësimit të nevojave dhe referimit⁷.

Mjediset e institucioneve

Institucionet e shërbimit rezidencial publik e ofrojnë shërbimin e tyre në ambiente fizike dhe me infrastrukturë të trashëguar nga e shkuara, dhe në shumicën dërrmuese të rasteve (me përjashtim të shtëpisë së Foshnjës “Hannah dhe Rozafa” në Tiranë dhe Shtëpisë së Fëmijës 0-5 vjeç në Durrës) janë të njëjtat godina që nga fillimi i ofrimit të shërbimit të strehimit dhe përkujdesjes për fëmijët pa prindër apo në pamundësi për përkujdesje në familje, duke datuar që prej viteve '40-'60. Pavarësisht se ka pasur ndërhyrje të vazhdueshme mirëmbajtjeje e rikonstruksioni (sipas mundësive dhe prioriteteve) dhe në disa raste edhe përpjekje për transformime të brendshme, me synim përafrimin e mjediseve me kushtet e modeleve “shtëpi-familje”, gjendja mbetet sërish problematike.

Vihet re një dallim në gjendjen dhe atmosferën e ambienteve të brendshme të institucioneve të përkujdesjes për fëmijët e grupmoshave të vogla 0-5 vjeç, ku qoftë si rezultat i madhësisë apo kapaciteteve pritëse, numrit relativisht të vogël të pritur aktualisht, etj., ambienti është relativisht më i ngrohtë në krahasim me 3 institucionet e përkujdesjes për fëmijët e grupmoshës 6-15 vjeç, që ofrojnë përgjithësisht një panoramë të mjerueshme.

Modelit shtëpi-familje i përafrohet institucioni i përkujdesjes shoqërore për fëmijët 0-5 vjeç në Durrës. Bazuar në këtë tipologji shërbimi, fëmijët janë të akomoduar në dy shtëpiza. Në shtëpizën e Durrësit janë 10 fëmijë dhe në shtëpizën e Shkozetit janë 11 fëmijë. Shërbimi ditë ofrohet në shtëpizën e Shkozetit në mjediset e katit të parë të godinës për familjet në nevojë.

Po ashtu, këtë tipologji shërbimi përpiqet ta ofrojë edhe shtëpia e fëmijës “Zyber

7. Neni 13, i ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Hallulli” në Tiranë, duke bërë një ndarje të fëmijëve në katër apartamente me elementet përkatëse, si dhoma e televizorit, kuzhina, dhomat e gjumit, dhomat e studimit, tualetet dhe dushet.

Aktualisht, mënyra e organizimit të mjediseve të brendshme në institucionet e tjera është pak a shumë e përafërt: mensa, kuzhina, lavanderia dhe magazinat ndodhen në katet përdhës dhe në katet e sipërme janë ambientet e fjetjes (të ndara sipas kateve, për vajza e djem), ambientet e përbashkëta të qëndrimit, si dhoma e televizorit, dhoma e takimit të fëmijëve me prindërit apo familjarët dhe vizitorë të tjerë, dhe zyrat e administratës. Klasat e studimit të fëmijëve janë të ndara sipas moshës shkollore ose biologjike, dhe janë të pajisura me banka, karrige dhe ajër të kondicionuar.

Pavarësisht se janë të mbajtura pastër dhe higjienike, ambientet mbeten të amortizuara, shpesh me lagështirë, dëmtime të mureve, dyerve apo pajisjeve, edhe me ndërhyrjet e herëpashershme për përmirësimin e infrastrukturës.

Higjiena e dhomave të fëmijëve dhe e vetë fëmijëve u paraqit në nivelin e duhur të pastërtisë dhe mirëmbajtjes, por në nivele minimale për sa u përket pajisjeve, duke krijuar një ndjenjë ftohtësie, distancimi dhe mungese atashimi të fëmijëve me mjediset ku jetojnë çdo ditë.

Pikat e mësipërme përbëjnë kushte të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për realizimin e mirëqenies së plotë të fëmijëve në çdo fushë të zhvillimit dhe nuk realizojnë krijimin e një hapësire të ngrohtë e mikpritëse ku fëmijët të mund të ndërtojnë ndjenjat e tyre të identitetit dhe përkatësisë.

Programet sociale, edukative dhe zhvillimore

Institucionet përmbushin detyrimet për informimin mbi natyrën, qëllimin dhe llojin e shërbimit të ofruar, kutinë e ankesave, mjetet e rrezikut ndaj zjarrit apo kamera të sigurisë.

Grupi inspektues kontrollon dosjet e stafit dhe dosjet e fëmijëve. Dosjet e edukatorëve përmbajnë, ndër të tjera, planin vjetor dhe mujor të punës, relacionin mujor mbi aktivitetet dhe punën e realizuar, punime të vetë fëmijëve, planin individual të fëmijëve, ditarë pune, si dhe Planin Edukativ Individual (PEI)⁸ për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë. Nëpërmjet hartimit të PEI-it, synohet që t’u vihet në ndihmë gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta edukative, si dhe mësuesve e punonjësve të tjerë mbështetës brenda institucionit rezidencial apo edhe shkollës që ndjek fëmija, për gjithëpërfshirjen e tyre në jetën sociale dhe arsimore.

Për çdo fëmijë është hapur dosje personale. Në përgjithësi, dosjet e fëmijëve përmbajnë vlerësimin e nevojave, planin e përkujdesjes, integrimin individual të fëmijëve dhe

8. Referuar ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 65 “Organizimi i arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara”, parashikohet se: 1) “Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta”.

raportet periodike mbi ecurinë e zhvillimit të tyre. Dokumentet janë të hartuara nga grupi multidisiplinor, i përbërë nga punonjësi social, psikologu, punonjësi përgjegjës që punon drejtpërdrejt me fëmijën, (kujdestari) dhe mjeku. Format i dokumentacionit të dosjeve të fëmijëve është rekomanduar nga grupi i punës, i ngritur në kuadër të procesit të deinstitutionalizimit, dhe plotësohet rregullisht dhe në të gjitha rubrikat.

Bazuar në planet mujore të veprimtarive argëtuese, zhvillohen aktivitete të ndryshme, si festimi i ditëlindjeve, zhvillimi i lojërave argëtuese, lojëra socio-edukative, etj.

Në plane janë parashikuar aktivitete që synojnë nxitjen e të kuptuarit dhe shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve, eksplorimin e dinamikave dhe marrëdhënieve familjare në përgatitje për situatën e pushimeve verore apo rikthimeve në familjet biologjike, eksplorimin dhe shprehjen e emocioneve negative si pasojë e situatave traumatike të përjetuara, trajtimin e temave që lidhen me pubertetin, leximin e librave jashtëshkollorë, aktivitete argëtuese e krijuese.

Të gjithë fëmijët në institucione frekuentojnë shkollat publike apo kopshtet në varësi të moshës së tyre, gjë që përbën një shenjë pozitive për edukimin, zhvillimin personal dhe integrimin e tyre në shoqëri.

Për sa u përket adoleshentëve 16-18 vjeç, të akomoduar në shtëpinë e fëmijës 16-18 vjeç, në Shkodër, disa prej tyre që nuk kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar të detyrueshëm frekuentojnë shkollën 9-vjeçare "Mari Logoreci", ndërsa fëmijët e tjerë zhvillojnë procesin mësimor në shkollën e mesme teknike pyjore "Kolë Margjini". Nga intervistat e realizuara me fëmijët, grupi inspektues konstatoi se kjo nuk është zgjedhja dhe dëshira e tyre, por drejtuesit e kanë parë si një ndër alternativat më të mira për ta, pasi duke qene se ka një numër të ulët nxënësish, krijon mundësinë e të punuarit në mënyrë të dedikuar me fëmijët; po ashtu nxënësve u jepet një pagesë mujore si nxitje për formimin profesional, pagesë që e marrin edhe fëmijët e akomoduar në institucion, pagesë që automatikisht u hidhet në një llogari bankare, e cila do t'ju shërbejë pasi të dalin nga institucioni.

Grupi i inspektimit shqyrtoi edhe regjistrin e interesimit nga familjarët e fëmijëve. Rezultoi se disa fëmijë kishin vizita nga një apo të dy prindërit, si dhe në raste të tjera rezultoi se janë realizuar telefonata me fëmijët. Pavarësisht se ligjërisht telefonata mund të konsiderohet si interesim, mbetet në vlerësimin e stafit psikosocial të institucionit për të vlerësuar cilësinë e kontakteve të fëmijëve me prindërit dhe anëtarë të tjerë të familjes biologjike, pasi ata japin informacion mbi ecurinë e zhvillimit psikoemocional dhe social të fëmijës në institucion, por dhe të mundësive të tij për rikthim ose jo në familjen biologjike apo të zgjeruar.

Numri, moshë dhe dinamika e lëvizjes së fëmijëve në institucionet e përkujdesjes:

Nga inspektimi u konstatua se numri i fëmijëve të pritur në qendrat e përkujdesjes shoqërore është në ndryshim të vazhdueshëm. Pavarësisht se numri i fëmijëve të

akomoduar në këto qendra është shumë më i vogël se kapacitetet e tyre pritëse, vlen të theksohet koha e gjatë e qëndrimit në këto institucione nga 1-7 vjet, si dhe transferimi i vazhdueshëm i fëmijëve nga një institucion te tjetri duke thëlluar traumën e braktisjes dhe institucionalizimit.

Fëmijët vendosen në qendrat e përkujdesjes shoqërore me Vendim të Këshillit Bashkiak ose me Vendim të Komisionit të Shërbimit Social Shtetëror, apo me Vendim të Gjykatës si masë mbrojtjeje.

Gjatë periudhës së inspektimit, statistikat mbi numrin e fëmijëve të pritur në qendrat e përkujdesjes shoqërore janë si më poshtë:

Shtëpia e Fëmijës 6-15 vjeç Sarandë ofron shërbim për 21 fëmijë të grupmoshës 6-15 vjeç.

- 10 fëmijë të moshës 6-10 vjeç
- 11 fëmijë të moshës 11-15 vjeç

Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç Vlorë ofron shërbim për 7 fëmijë:

- 1 fëmijë i moshës 0-3 vjeç
- 2 fëmijë të moshës 3-5 vjeç
- 4 fëmijë mbi 5 vjeç.

Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç "Hannah dhe Rozafa" ofron shërbim për 26 fëmijë:

- 17 fëmijë i përkasin moshës 0-3 vjeç;
- 4 fëmijë i përkasin moshës 3-5 vjeç;
- 5 fëmijë janë mbi 5 vjeç.

Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç Durrës ofron shërbim për 21 fëmijë në shërbim rezidencial nga të cilët:

- 9 fëmijë të moshës 0-3 vjeç
- 12 fëmijë të moshës 3-7 vjeç

Po ashtu, ofrohet shërbim ditor për 9 fëmijë.

Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç Shkodër ofron shërbim për 17 fëmijë të moshës 0-6 vjeç:

- 4 fëmijë të moshës 0-3 vjeç
- 13 fëmijë të moshës 3-7 vjeç.

Shtëpia e Fëmijës 6-15 vjeç Shkodër ofron shërbim për 24 fëmijë rezidentë:

- 10 fëmijë të moshës 6-12 vjeç,
- 10 fëmijë të moshës 13-15 vjeç
- 3 fëmijë të moshës 16 vjeç.

Fëmijët e pritur në këtë institucion vijnë nga bashkitë si vijon: Shkodra-2 fëmijë, Tirana-10 fëmijë, Korça-3 fëmijë, Kavaja-3 fëmijë, Bulqiza-2 fëmijë, ndërsa Kavaja, Berati, Kuçova, Saranda dhe Kruja nga 1 fëmijë.

Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç Korçë ofron shërbim për 6 të mitur përfitues, 3 djem dhe 3 vajza, të gjithë nga qarku i Korçës.

Shtëpia e Fëmijës 15-18 vjeç Shkodër ofron shërbime të përkujdesjes shoqërore për 17 fëmijë (11 djem e 6 vajza), të transferuar nga institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale të grupmoshës 6-15 vjeç, konkretisht nga Shtëpitë e Fëmijës 6-15 vjeç Sarandë, Tiranë dhe Shkodër.

Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli" Tiranë ofron shërbime përkujdesjeje për 39 përfitues 6-15 vjeç, prej të cilëve 27 janë meshkuj dhe 12 janë femra,

- 32 fëmijë të moshës 6-12 vjeç,
- 7 fëmijë të moshës 13-15 vjeç.

16 përfitues janë akomoduar në institucion si raste emergjente nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës, 22 përfitues janë transferuar nga institucionet e përkujdesjes shoqërore që ofrojnë shërbime përkujdesjeje për grupmoshat nga 0-5 vjeç, 2 përfitues janë vendosur në institucion me vendim gjykatë.

Deinstitucionalizimi

Procesi i deinstitucionalizimit të sistemit të kujdesit për fëmijët bazohet në ndryshimin e tipologjisë së shërbimeve nga institucione përkujdesjeje rezidenciale në shërbime ditore dhe shërbime të tjera alternative me bazë komunitare e familjare, duke synuar integrimin e fëmijëve në familje, qofshin ato biologjike apo kujdestare, në interesin më të lartë të fëmijës. Ashtu si shumë vende të tjera, vendi ynë e ka njohur rëndësinë e sigurimit të një mjedisi familjar për fëmijët dhe ka punuar për këtë proces me qëllim sigurimin e mirëqenies dhe zhvillimit të tyre. Deinstitucionalizimi nuk duhet kuptuar thjesht si mbyllja e institucioneve për fëmijët, por si procesi i transformimit gjithëpërfshirës të strukturave kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Nëse vendosja në kujdesin alternativ është qartësisht në interesin më të lartë të fëmijës, duhet të ekzistojnë disa mundësi zgjedhjeje në përputhje me situatën individuale të fëmijës, nevojat specifike dhe dëshirat e tij, si dhe në përputhje me aftësinë e fëmijës për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes. Këto alternativa përfshijnë kujdes brenda familjes së zgjeruar (farefis), vendosje në familje kujdestare pa lidhje gjaku, shërbime si komunitete të vogla familjare (shtëpi-familje) apo birësim. Përpara mbylljes së institucioneve, duhet të krijohen dhe të jenë funksionale një sërë shërbimesh gjithëpërfshirëse e cilësore si në parandalim, mbështetje dhe fuqizim të familjes biologjike, shërbime alternative të fuqizuara e të monitoruara.

Në zbatim të Planit Kombëtar të Deinstitucionalizimit, procesi ka nisur të pilotohet në institucionet e përkujdesjes shoqërore për fëmijët e moshës 0-5 vjeç në Korçë dhe Vlorë.

Përpyekjet për deinstitucionalizimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për fëmijët në Shqipëri janë drejtuar nga parimet e përshkruara edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, si dhe në Udhëzuesin e Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve. Këto parime theksojnë të drejtën e fëmijëve për t'u rritur

në një mjedis familjar, ku interesi i fëmijës të jetë parësor, si dhe garantimin e parimit të përshtatshmërisë dhe domosdoshmërisë.

Procesi i deinstitutionalizimit në Shqipëri përfshin disa komponentë kyç, si:

Parandalimi: Janë bërë përpjekje për të parandaluar ndarjen e familjes dhe për të mbështetur familjet në rrezik ndarjeje përmes shërbimeve dhe ndërhyrjeve të synuara. Këtu përfshihen ofrimi i këshillimit, ndihmës financiare dhe aksesit në arsim dhe kujdes shëndetësor, programe mbështetëse për prindërimin, etj. Qëllimi është parandalimi i ndarjes së fëmijës nga familja, ndaj fokusi është fuqizimi i bërthamës familjare, përmes mbështetjes në një aspekt shumëplanësh, nga mbështetja ekonomike tek ajo sociale.

Kujdesi me bazë familjare: Theksi vihet në gjetjen e alternativave të përshtatshme të kujdesit të bazuar në familje për fëmijët që nuk mund të jetojnë me familjet e tyre biologjike dhe pranë tyre. Këtu përfshihet kujdestaria pa lidhje gjaku, kujdesi në familjen e zgjeruar (farefisnor) ose birësimi.

Forcimi i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve: Kapaciteti dhe burimet e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve janë përmirësuar për të siguruar mbështetjen e duhur për fëmijët dhe familjet në nevojë. Këtu përfshihet trajnimi i punonjësve socialë, krijimi i mekanizmave efektivë të referimit, forcimi i mbikëqyrjes dhe monitorimi i vazhdueshëm deri në fuqizimin e tyre.

Zhvillimi i shërbimeve me bazë komunitare: Shërbimet dhe rrjetet mbështetëse të bazuara në komunitet janë krijuar për të ofruar ndihmë për familjet në nevojë dhe për të mbështetur riintegrimin e fëmijëve në komunitetet e tyre. Këto shërbime mund të përfshijnë këshillimin, arsimin, kujdesin shëndetësor, trajnimin profesional, etj.

Referuar evidencave/statistikave⁹, konkretisht atyre të muajve shtator-dhjetor 2022, rezulton se nga shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç Vlorë, vetëm një fëmijë është rikthyer në familjen biologjike nga institucioni i përkujdesjes shoqërore (IPSH). Ky numër i papërfillshëm vjen edhe si rrjedhojë e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore, për të cilat gjykatat marrin kohë të konsiderueshme për t'u shprehur me vendim për qëndrimin apo rikthimin në familje të fëmijëve të pranuar si raste emergjente, por, njëkohësisht, edhe për shkak të punës së pamjaftueshme nga strukturat vendore për fuqizimin e familjeve të këtyre fëmijëve apo identifikimin dhe përgatitjen e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku.

Në rang vendi, shumica dërrmuese e rasteve të kujdestarisë janë ato me lidhje gjaku, ndërsa numri i fëmijëve të vendosur në kujdestari alternative pa lidhje gjaku është mjaft i ulët. Deri në fund të vitit 2021, asnjë Njësi e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) nuk kishte hartuar dhe miratuar listën e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku¹⁰.

9. Konstatohet se 2(dy) fëmijë janë vendosur në institucionin e përkujdesjes shoqërore (IPSH) si raste emergjente bazuar në vendimet e marra në Grupet Teknike Ndërsektoriale, 8 (tetë) rastet e tjera të fëmijëve janë vendosur në këtë institucion me vendim të gjykatës për caktimin e kujdestarisë në IPSH.

10. <https://www.unicef.org/albania/media/4391/file/AKDF%202021-2026%20ALB.pdf>, paragrafi 1, faqja 26.

Po ashtu, në shtëpinë e fëmijës 0-5 vjeç Korçë rezulton se procesi i fuqizimit të familjeve, kthimi i fëmijëve në familje kujdestare profesionale apo me lidhje gjaku, nuk është kryer. Bashkia Korçë nuk ka arritur të krijojë shërbime të specializuara dhe as të parandalojë ndarjen e fëmijëve nga prindërit, të cilët janë në pamundësi të ushtrimit të kujdesit prindëror.

Deinstitutionalizimi ka funksionuar vetëm në drejtim të largimit të fëmijëve në institucione të tjera përkujdesjeje rezidenciale për fëmijët e moshës shkollore dhe për efekt birësimi, e jo për arsye të kthimit të tyre në familjet biologjike ose familjet kujdestare të fuqizuara ekonomikisht. Kalimi i fëmijëve nga një institucion në një tjetër, larg familjeve biologjike, pra në qytete të tjera të Shqipërisë, krijon probleme ekonomike e sociale, dhe vështirësi në komunikimin e kujdestarisë së fëmijës.

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

Interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë synimi kryesor në çdo vendim që merret mbi jetën e fëmijës, si nga institucionet shtetërore apo ato private të përkrahjes shoqërore, ashtu dhe nga gjykatat dhe organet e administratës shtetërore.

Pushteti vendor duhet të ndërmarrë hapa konkretë në përbushje të qëllimit për fuqizimin e familjeve të fëmijëve të vendosur në institucionet rezidenciale dhe për evidentimin e familjeve kujdestare¹¹.

Pamundësia ekonomike nuk është shkak i mjaftueshëm që autoritetet shtetërore të vendosin ndarjen e fëmijës nga familja ose të afërmit me të cilët jeton.

Në rast se prindi ose kujdestari, pavarësisht vullnetit, nuk arrin përbushjen e nevojave bazë të fëmijës për mbijetese e zhvillim, autoritetet shtetërore kanë detyrimin ligjor dhe moral të marrin të gjitha masat për të ndihmuar prindërit në realizimin e detyrimeve ndaj fëmijës.

Institucioni i Avokatit të Popullit e vlerëson si shqetësues problemin e institucionalizimit të fëmijëve, të cilët, në fakt, marrin vetëm shërbimet jetike bazë në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale. Qëndrimi afatgjatë i fëmijëve në institucion, kalimi i fëmijëve nga një institucion në një tjetër sjell pasoja negative për zhvillimin psikosocial të tyre. Fakti që fëmijët vijojnë me qëndrim afatgjatë në institucione rezidenciale tregon mungesë të planifikimit dhe realizimit të programeve të fuqizimit të familjes, si dhe të aftësive prindërore të familjeve biologjike apo familjes së zgjeruar të fëmijëve në përkujdesje shoqërore, shoqëruar kjo edhe me ndërhyrjet e duhura në drejtim të shëndetit mendor të prindërve, familjarëve të tjerë apo edhe vetë fëmijëve në kujdes rezidencial; mungesë të planifikimit, ngritjes dhe ofrimit të programeve rehabilituese për të rritur dhe fëmijë përdorues të alkoolit apo substancave të tjera, etj., apo të programeve

11. Sipas VKM nr. 149/2018 "Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare".

të mirëfillta rehabilituese e riintegruese për prindër që dalin nga sistemi i drejtësisë ose edhe fëmijë e adoleshentë me sjellje të rrezikshme dhe që janë në rrezik, apo që janë në kontakt/konflikt me ligjin.

Mosveprimi apo mungesa e proaktivitetit nga ana e organeve të administratës publike për ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore për fuqizimin e individëve dhe familjeve biologjike, dhe evidentimin e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku në njësitë e qeverisjes vendore përkatëse ka ndikuar negativisht sa i përket ecuresë pozitive të procesit të deinstitutionalizimit dhe largimit të fëmijëve nga institucionet. Nga vlerësimi i informacionit të gjeneruar, koha e gjatë e qëndrimit të fëmijëve në institucion është problematike dhe mund të konsiderohet një formë neglizhimi¹².

Shërbimi rezidencial, edhe kur ofrohet si zgjidhja e fundit për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdesin e duhur prindëror¹³, sjell pasoja të rënda në zhvillimin mendor, fizik, psikologjik dhe social të tyre. Qëndrimi për një kohë të gjatë në institucione shfaqet me sjellje provokuese, agresivitet, vonesa në zhvillimin konjitiv e emocional të fëmijës dhe të aftësive për integrim social. Institucionet nuk arrijnë të sigurojnë kujdesin dhe vëmendjen individuale ndaj çdo fëmije, si dhe dashurinë që fëmija e merr në familje.

Deinstitutionalizimi¹⁴ nuk duhet kuptuar thjesht si mbyllja e institucioneve për fëmijët, por si procesi i transformimit gjithëpërfshirës të strukturave kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Ai përfshin marrjen e masave parandaluese dhe mbrojtëse për të siguruar zgjidhje të nevojshme dhe të përshtatshme të kujdesit alternativ për fëmijët që nuk mund të qëndrojnë me familjet e tyre biologjike.

Plani kombëtar i deinstitutionalizimit 2020-2022 shënoi në vetvete fillimin e mirë të punës për të eliminuar institutionalizimin e fëmijëve në vendin tonë. Ndërtimi i një sistemi të integruar të shërbimeve sociale, multifunksionale e në përputhje me standardet bashkëkohore synon riintegrimin e fëmijëve në jetën normale, për të siguruar një mjedis natyror për rritjen, mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijës, siç është familja.

Shtyrja e afatit kohor për zbatimin e planit të deinstitutionalizimit është element që tregon vështirësinë e këtij procesi, i cili kërkon koordinim dhe harmonizim të mirëfilltë të çdo veprimi mes pushtetit qendror dhe vendor. Detyrimi dhe angazhimi i bashkive për ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve të reja (shërbim mbështetës për fëmijën dhe familjen, kujdes alternativ profesional, etj.) duhet njëzuar me përpjekjet e pushtetit qendror për krijimin e kushteve të përshtatshme, si në kuadrin ligjor, mekanizmat institucionalë dhe financiarë për pilotimin e shërbimeve të reja, me qëllim që pas pilotimit këto shërbime të realizohen në mënyrë të standardizuar në të gjitha bashkitë.

12. Në zbatim të pikës 10, të nenit 3 të ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", "Neglizhimi i fëmijës" është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.

13. Neni 267, i ligjit nr. 9062, datë 8.5.2003, "Kodi i Familjes", përcakton një kusht të qartë duke konsideruar institutionalizimin e fëmijës si mundësi të fundit.

14. Në shtator të vitit 2020 u miratua Plani Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020-2022, i cili mendohet të shtyhet deri në vitin 2024 për të mundësuar që çdo fëmijë në institucionet e përkujdesjes, apo në rrezik institucionalizimi, të mbështetet me shërbime të reja alternative, në familje kujdestare apo shërbime të specializuara.

Asnjë Njësi e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) nuk ka hartuar dhe miratuar listën e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku¹⁵. Kohëzgjatja e proceseve administrative e gjyqësore ndikon në këtë drejtim, e po ashtu edhe mungesa e shërbimeve të specializuara në nivel vendor, të gatshme për të ofruar mbështetje për përshtatje dhe integrim të sigurt të fëmijës në familjen kujdestare.

Shumica dërrmuese e rasteve të kujdestarisë janë ato me lidhje gjaku, ndërsa numri i fëmijëve të vendosur në kujdestari alternative pa lidhje gjaku është krejt i papërfillshëm.

Koha e qëndrimit të fëmijëve në institucion cilësohet e gjatë, pasi varion nga minimumi 1 vit e deri në 7 vjet. Ky tregues është shqetësues, pasi nuk është në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, që nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar jetë familjare e sociale të përshtatshme për të¹⁶.

Funksionimi i brendshëm dhe organizimi i shërbimit në institucionet e përkujdesjes shoqërore realizohet sipas rregulloreve të brendshme të bazuara në rregulloren “tip” të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH-së në vitin 2017, me përmbajtje të përgjithshme, pa specifika sipas profilit të secilit shërbim. Mungesa e profilizimit specifik për çdo institucion të përkujdesjes shoqërore në brendësi të rregullores mund të bëhet pengesë për realizimin e objektivave kryesore të këtyre lloj institucionesh. Rregullorja nuk është e përditësuar me legjislacionin e ri të shërbimeve sociale¹⁷. Nga ana tjetër, këto ligje dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre trajtojnë dhe rregullojnë aspekte apo faza të institucionalizimit, si dhe mbështetjen apo mbrojtjen që i jepet fëmijës, nëpërmjet shërbimeve të ndryshme të përkujdesjes.

Gjatë kryerjes së kontrollit të dokumentacionit, AP-ja konstatoi se MSHMS-ja e ka zbatuar pjesërisht rekomandimin lidhur me indeksimin e kuotës financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve të përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet e përkujdesjes shoqërore për fëmijët në nevojë, me miratimin e Udhëzimit nr. 662, datë 06.12.2022, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për një ndryshim në

15. <https://www.unicef.org/albania/media/4391/file/AKDF%202021-2026%20ALB.pdf>, paragrafi 1, faqja 26.

16. Pika 3, e nenit 6 të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

17. Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Vendimi nr. 578, datë 3.10.2018, i Këshillit të Ministrave “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”; Udhëzimi nr. 556, datë 29.7.2019, “Për mënyrën e vendosjes në institucionet e përkujdesjes shoqërore, për fëmijën ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje”; Udhëzimi nr. 584, datë 31.7.2019, “Për rregullat, procedurat dhe veprimet konkrete të autoriteteve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe detyrimet e personelit mjekësor ose të profesionistëve të fushave të tjera, që lidhen me parandalimin ose trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor”; Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”; Vendimi nr.136, datë 7.3.2018, i Këshillit të Ministrave “Për funksionimin dhe administrimin e Regjistrat Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror”; Vendimi nr.149, datë 13.3.2018, i Këshillit të Ministrave “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”; Vendimi nr. 518, datë 4.9.2018, i Këshillit të Ministrave “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”; Udhëzimi nr. 689, datë 2.10.2018, “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”; Vendimi nr. 150, datë 20.3.2019, i Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”; Udhëzimi nr. 394, datë 9.5.2019, “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit multidisiplinar, si dhe procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimit të përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare”.

udhëzimin nr. 689, datë 2.10.2018, të ministrit, “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqim, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”. Ky ndryshim lidhet me përcaktimin e institucionit përgjegjës, (Shërbimi Social Shtetëror) për të kryer indeksimin çdo vit, sipas indeksit të çmimeve të konsumit, të niveleve të kuotave të shpenzimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”. Nga ana tjetër, në zbatim të pikës 70, të Vendimit nr. 518, datë 04.09.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare miratohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Për sa më sipër, nëse Udhëzimi nr. 662/2022 i lartpërmendur ngarkon SHSSH-në të indeksojë nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”, sipas çmimeve të konsumit, MSHMS-ja duhet të miratojë nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare, ku përfshihet dhe nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”, pasi miratimi i këtij akti nënligjor ka efekte financiare dhe bëhet pjesë e parashikimit buxhetor në programin e “mbrojtjes sociale” të MSHMS-së.

Plotësimi i dosjeve konsiderohet një proces formal burokratik që duhet kryer dhe jo një element i rëndësishëm për garantimin e mirërritjes dhe zhvillimit harmonik të fëmijës, duke parë interesin më të lartë të fëmijës, p.sh. kthimin e tyre në familjen biologjike apo fillimin e jetesës gjysmë të pavarur, pasi të mbushin moshën 18 vjeç.

Gjatë intervistave të realizuara me adoleshentët, grupi i inspektimit vërejti me shqetësim masat e kufizuara të marra për dhënien e informacionit mbi shërbimet publike dhe private jashtë institucionit (programet e nxitjes së punësimit, strehimit social, etj.), të cilat do t’i ndihmonin fëmijët në procesin e vendimmarrjes (si p.sh. fletëpalosje, broshura të ndryshme ose faqe interneti që përmbanin këtë informacion të domosdoshëm për procesin e integritetit) para largimit nga institucioni.

REKOMANDIME

Konsiderata të përgjithshme:

Mbrojtja e të drejtave të fëmijës nis që në familje, nga prindërit, ndaj për të parandaluar dhe pakësuar risqet e mundshme me të cilat mund të përballen fëmijët dhe për t'i pajisur prindërit me aftësitë përkatëse proaktive jo të dhunshme për të rritur fëmijët, prindërit kanë nevojë për mbështetje nga institucionet e pushtetit vendor, si dhe nga aktorë të tjerë, që janë pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës. Ndërhyrjet dhe shërbimet duhet të bazohen mbi nevojat, sidomos ato specifike të fëmijës dhe familjes, si dhe duhet të jenë të përshtatura për fëmijën.

Këto ndërhyrje duhet të pasqyrojnë frymën e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, si dhe të legjislacionit për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve, konkretisht ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të cilët, ndër të tjera, garantojnë të drejtën e fëmijës për ofrimin e shërbimeve mbështetëse, në rastet kur fëmijët mbeten jashtë përkujdesjes familjare për faktorë natyralë, socialë apo ligjorë. Ndaj, duhet të vijojë puna dhe përpjekjet nga organet e administratës shtetërore për ngritjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për fuqizimin e familjeve dhe krijimin e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore për të larguar fëmijët nga institucionet.

Avokati i Popullit e vë theksin në ndërmarrjen e të gjitha veprimeve nga autoritetet shtetërore për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e fëmijës, në mënyrë që fëmijët dhe të rinjtë, pa dallim, të gëzojnë të drejtat e tyre.

Këtë vit, Institucioni i Avokatit të Popullit mori pjesë në raportimin e shtetit shqiptar për Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, të mbajtur në Gjenevë, Zvicër. Duke i sjellë në vëmendje shtetit shqiptar Udhëzimet për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve, ky komitet i rekomandoi qeverisë shqiptare që të:

- (a) Përshpejtojë deinstitutionalizimin duke kryer ndryshime programore dhe buxhetore nga mjediset institucionale drejt mjediseve të kujdesit alternativ të bazuar në komunitet dhe në familje;
- (b) Miratojë rregullore për t'i nxitur bashkitë/institucionet vendore që të ofrojnë një paketë minimale shërbimesh kujdesi për fëmijën, me qëllim parandalimin e ndarjes së panevojshme të fëmijëve, duke u kushtuar vëmendje të veçantë familjeve të varfra dhe atyre me fëmijë që kanë aftësi të kufizuara;
- (c) Sigurojë alternativa/mundësi të mjaftueshme kujdesi alternativ të bazuar në familje dhe në komunitet për fëmijët që nuk mund të qëndrojnë me familjet e tyre,

përfshirë edhe akordimin e burimeve financiare të përshtatshme për kujdesin në familje kujdestare dhe birësimin, duke shqyrtuar rregullisht masat e vendosjes së fëmijëve në kushte kujdesi dhe duke lehtësuar ribashkimin e tyre me familjet përkatëse, kur është e mundur;

- (d) Sigurojë që kushtet e vështira financiare dhe materiale, apo kushtet që lidhen drejtpërdrejt dhe posaçërisht me një situatë të tillë, të mos përbëjnë asnjëherë një justifikim për vendimet që lidhen me largimin e një fëmije nga kujdesi prindëror ose me referimin e fëmijës në kujdes alternativ apo riintegrim;
- (e) Krijojë një shërbim kujdestarie të qëndrueshëm, profesional dhe eficient, dhe të adresojë normat shoqërore që favorizojnë kujdesin institucional kundrejt atij në familje kujdestare;
- (f) Ofrojë mbështetje të posaçme për fëmijët që largohen nga kujdesi institucional drejt jetesës së pavarur.

Prandaj, duhet të vijojë puna dhe përpjekjet nga organet e administratës shtetërore për ngritjen dhe fuqizimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore me baze familjare e komunitare, për fuqizimin e familjeve dhe krijimin e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore për t'i larguar fëmijët nga institucionet.

Më konkretisht, AP-ja rekomandon:

- Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratimin e kuotës ushqimore të indeksuar nga Shërbimi Social Shtetëror në zbatim të pikës 70, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, sipas çmimeve të konsumit, sipas të cilës MSHMS-ja duhet të miratojë nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesjes shoqërore në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare, ku përfshihet dhe nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”, pasi ky miratim ka efekte financiare.
- Marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për fëmijët në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike dhe private për fëmijët e grupmoshës 0-6 vjeç.
- Marrjen e masave urgjente për përmirësimin e infrastrukturës dhe mjediseve të institucioneve, duke bërë të mundur krijimin e kushteve normale të jetesës në një ambient të ngrohtë e miqësor.
- Marrjen e masave për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës nga institucionet përgjegjëse shtetërore që veprojnë në këtë fushë, (si p.sh. njësitë për mbrojtjen e fëmijëve, shërbimet komunitare të shëndetit mendor, shërbimet ditore për fëmijët

në nivel vendor, institucionet arsimore, si edhe shërbimet shëndetësore parësore, etj.) për trajtimin, mbrojtjen, integrimin dhe monitorimin e të gjitha rasteve të fëmijëve në procesin e deinstitucionalizimit, duke garantuar interesin më të lartë të tyre.

- Marrjen e masave nga pushteti vendor në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror për ofrimin e programeve mbështetëse për prindërit biologjikë dhe familjet kujdestare, ndjekjen e fëmijëve gjatë ofrimit të shërbimit të kujdestarisë.
- Marrjen e masave nga pushteti vendor për fuqizimin e familjeve biologjike dhe të shërbimit të kujdestarisë¹⁸ për fëmijët në nevojë, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë (me qëllim rritjen e numrit të familjeve që do të ofrojnë shërbimin e kujdestarisë), si dhe për ndikimet negative që ka në zhvillimin e fëmijëve vendosja e tyre në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore .
- Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratimin e manualeve për plotësimin e standardeve për tipologji shërbimi shtëpi-familje.
- Marrjen e masave nga institucionet rezidenciale për përfshirje më të madhe dhe më domethënëse të fëmijëve në të gjitha çështjet që lidhen me ta, duke iu marrë mendimin për planet e të ardhmes dhe duke i informuar ata për shërbimet, si dhe adoleshentëve dhe të rinjve 16-18 vjeç mbi programet parapërgatitore gjysmë të pavarura publike dhe jopublike, strehimin social, kurset e formimit profesional, orientimin drejt tregut të punës, etj.
- Rritjen e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, për të krijuar programe mbështetëse për prindërit dhe kujdestarët, të cilat synojnë krijimin dhe prezantimin e praktikave të mira për mirërritjen e fëmijëve, bazuar në njohjen e të drejtave të fëmijëve, zhvillimin e tyre dhe teknikat disiplinore pozitive dhe për mbështetjen e familjeve për t'u siguruar fëmijëve kujdes¹⁹ dhe një mjedis të sigurt.
- Marrjen e masave nga pushteti vendor për të ofruar tipologji të reja të shërbimeve sociale me fokus fëmijët dhe familjen, për të bërë të mundur progresin e familjeve që mbartin probleme të ndryshme sociale dhe ekonomike ndër vite, me qëllim garantimin e mbrojtjes së fëmijëve, dhe shmangien e institucionalizimit për një kohë të gjatë të tyre.
- Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror për realizimin e trajnimeve për shtimin e njohurive të stafit të institucioneve, me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore, në përputhje me standardet, si dhe ofrimin e programeve dhe aktiviteteve socio-kulturore në komunitet me fëmijët dhe për fëmijët.

18. VKM nr. 149, datë 13.03.2018, "Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare".

19. Bazuar dhe në përcaktimet e ligjit nr. 126/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

- Marrjen e masave nga ana e institucioneve të përkujdesjes shoqërore për plotësimin e dosjeve të fëmijëve, duke përmbledhur historikun social të fëmijëve në një format të vetëm dhe ndarjen e dosjeve të përfituesve të ardhura nga institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale, nga të cilat janë transferuar këta fëmijë me dosjen personale të fëmijës në institucionin pritës.